

Lopët në tharje të ushqehen në mënyrën e duhur

*Përgatitur nga Franz Riegler, konsulent i Schaumann dhe
Aksioner i AUSTRIA Praemix shpk.*

Përkthyer dhe përpunuar nga Olger Nanagjoka



Të ushqyerit në periudhën e tharjes ndikon ndjeshëm mbi shëndetin e kafshëve dhe rendimentin në laktacionin e ardhshëm. Por se si mund të ushqehen sa më mirë lopët, shpjegohet në artikullin e mëposhtëm.

Në parim, të gjitha ushqimet duhet të jenë higjenikisht të pastra dhe konsumi i tij nuk duhet të kufizohet në periudhën e tharjes. Furnizimi me energji nëpërmjet ushqimit duhet të bëhet me kujdes në mënyrë që lopët të mos dhjamosen dhe pjellja të mund të kryhet në kushte optimale. Gjithashtu duhet të kontrollohet vazhdimisht gjendja trupore dhe të matet trashësia e dhjamtit në kurriz.

Të ushqyerit me dy faza

Për shkak të kërkesave të ndryshme për lëndë ushqyese gjatë periudhës së tharjes, të ushqyerit duhet të bëhet me dy faza. Në fillim të periudhës së tharjes, konsumi i ushqimit nuk është i lartë prandaj edhe kërkesa për energji është ende e ulët. Normalisht mjafton ushqimi voluminoz me përmbajtje energjie të mesme (5,5 deri në 5,8 MJ NEL për çdo kg masë të thatë). Më pas është e domosdoshme të ofrohet ushqim voluminoz me përmbajtje më të lartë energjie. Racionit t'i shtohet bar i thatë ose kashtë. Gjithashtu edhe nevoja për proteina është relativisht e ulët rreth 12-13 % në masën e thatë. Koncentratet shtesë gjatë kësaj faze nuk janë të nevojshme. Vetëm për lopët me gjendje trupore të dobët ose kur ushqimi voluminoz ka përmbajtje të ulët energjie (kashtë, përmbajtje të lartë të mbetjeve të barit) mund të jetë i nevojshëm shtimi i koncentratit në racionin ushqimor.

Përgatitja për laktacion

Dy javë para pjelljes duhet t'i jepet lopës përsëri koncentrat. Në këtë fazë rritet ndjeshëm nevoja për lëndë ushqyese dhe kafshët duhet të jenë të përgatitura për racionin ushqimor të lopëve në laktacion. Me 1-3 kg koncentrat në ditë, mbulohet nevoja për energji e lopës, stimulohet formimi i vleve dhe popullimi mikrobial në rumen ndryshon.

Racioni i njëjtë përgjatë gjithë periudhës së tharjes është e shtrenjtë

Një racion njëfazor me sasi të lartë të koncentratit gjatë periudhës së tharjes nuk është e rekomandueshme. Në racionet e periudhës së tharjes jepen deri në 4 kg koncentrat. Në mënyrë që kafshët të mos mbifurnizohen me energji, racioni i koncentratit përzihet me kashtë ose jepet i racionuar. Një përqëndrim i energjisë duhet të jetë pak më shumë se 6 MJ NEL. Disavantazh i kësaj strategjie të të ushqyerit është çmimi i lartë i racionit me koncentratë shtesë. Gjithashtu edhe kashta duhet të blihet më shtrenjtë.

Probleme të tjera

Shtimi i lartë i kashtës në racione, ul jo vetëm sasinë e energjisë dhe të proteinave, por edhe të oligoelementëve dhe vitaminave. Për pasojë është e nevojshme furnizimi me ushqim të pasur me minerale. Meqënëse cilësia e kashtës është e ndryshme, lind problemi me higjenën. Racionet me sasi të lartë kashte mund të zgjidhen lehtësisht nga lopët. Rezultati është se lopët vazhdojnë të konsumojnë koncentrat, rrezikojnë të dhjamosen dhe të kenë çrregullime metabolike. Në laktacionin e rradhës kafshët konsumojnë më pak ushqim dhe rreziku i ketozës rritet. Të gjitha anët negative të lartëpërmendura nëse ushqejmë një racion ushqimor përgjatë gjithë fazës së tharjes, kanë edhe anën pozitive të tyre e cila konsiston në mosndryshimin e vleve nëpërmjet ndryshimit të ushqimit por mbajtjen konstate të tyre, fenomen i cili shihet si pozitiv.